



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:149870

Datë: 30.08.2022

Numri i dokumentit: 03374364

P. nr.330/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. R. nga Tirana Rep. e Shqipërisë, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë PP.nr. 1100/22 të datës 08.08.2023, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datë **26.08.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Syla, të dëmtuarit G. K., mbrojtësit të akuzuarit av. Meshari Selimaj si dhe të akuzuarit A. R. me datën 30.08.2022, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. R. nga Tirana**, Republika e Shqipërisë, me banim në rr. . . , data e lindjes . . . , në Tiranë, R. e Shqipërisë i biri i E. dhe i P., e gjinisë A., ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i papunë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas Republikës së Shqipërisë, me numër personal . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

- me dt.22.06.2022 rreth orës 12:00, në Rr..” . . .” në Gjakovë, konkretisht tek rentacar “. . .” me anë të paraqitjes së rreme të fakteve dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, i pandehuri A.e mashtron të dëmtuarin G. K., në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike kishte shkuar tek i dëmtuari G. i cili kishte biznes për lëshimin e veturave me qira dhe aty kishte marrë me qira një veturë te tipit “. . .” me targa . . .për ta shfrytëzuar për dy ditë deri me dt.24.06.2022 por duke mos e bërë pagesën, ashtu qe me dt.24.06.2022 i dëmtuari e telefon për t’ia kthyer veturën por i pandehuri i thotë se do ta mbaj edhe një dite deri me dt.25.06.2022, pasi që e kishte vajzën e sëmurë por që edhe pas kësaj date nuk ia kthen veturën, me ç’rast të dëmtuarit i shkakton dëm material.

-me çka ka kryer veprën penale Mashtrim nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në kuptim të neneve 4, 7,17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 79 si dhe nenit 323 par 1 të KPRK-sël dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin e :

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË në shumë prej **400.00-€ (katërqind euro)**, të cilin dënim është i obliguar qe te paguaj ne afatin prej 30 ditëve ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë, si dhe

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej **8(tetë) muaj**, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim **nga data 22.07.2022 e tutje** .

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 43 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **15 (njëzet) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00-€.(njëzet) euro**, të gjobës.

I dëmtuari G. K. nga Gjakova Rr.”. . . , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30.00 €**, si dhe në emër të te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00 €**, në afat prej 15 ditëve ,pasi Aktgjykimi të marr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

A r s y e t i m

1.Ecurija e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzës PP/II.nr.1100/22 të datës 08.08.2022,,kundër të akuzuarit A. R. nga Tirana Rep. Shqipërisë ,për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Mone Syla , gjatë shqyrtimit të mbajtur me datën 26.08.2022 ka qëndruar në tersi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit A. R. , andaj i ka propozuar Gjykatës që i njëjti të shpallen fajtor, dhe të dënohet sipas Ligjit. Në fjalën përfundimtare me datë 26.08.2022,prokurori i shtetit Mone Syla deklaroi: me që i akuzuari në këtë shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohet sipas aktakuzës, e cila edhe është e mbështetur ne provat dhe faktet e aktakuzës , pas analizimit dhe vlerësimit te gjitha provave qe i përmban aktakuza si ato personale dhe materiale deklaroi se aktakuza përmban mirë figurën e veprës penale te mashtrimit nga neni 3232/1 te KPRK-ës, prandaj gjykatës i propozoi qe te akuzuarit te shpallë fajtor ,te dënohet sipas ligjit duke i marr për bazë te gjitha rrethanat lehtësuese siç është pranimi i fajësisë e po ashtu edhe ato renduese te parapara me ligj dhe te obligohet ne kompensimin e demit te shkaktuar te dëmtuarit dhe shpenzimeve te procedurës penale .

I akuzuari A. R. në shqyrtimin gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Meshari Selimaj , deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën akuzohem duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë në mënyrë vullnetare dhe pa presion.,

Mbrojtësi i te akuzuarit av. Meshari Selimaj , deklaroi se unë theksojë se pranimi i fajësisë ne këtë fazë te procedurës i pandehuri e ka bere ne mënyrë te vullnetshme dhe pa presion, ani pse gjatë tere kohës deri ne shqyrtimin e sotëm unë me te njëjtin kam bashkëbiseduar ne kontekstin ligjor dhe atë ne aspektin se kodi penal ne nenin 318 e KPRK-ës, e parasheh edhe veprën penale te shpërdorimit te pasurisë se huaj, ashtu qe se bashku i kemi trajtuar veçantit apo dallimet e këtyre veprave penale marr parasysh edhe dallimin ne dënim i cili parashihet tek te dyja veprat penale .E rëndësishme është se i njëjtit i kupton pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë , e ka kuptuar mirë aktakuzën dhe për te njëjtën deklarohet i fajshëm dhe një deklarim te tillë nuk e kundërshtojë duke e konsideruar si pranim i vullnetshme dhe ne përputhje me dispozitën e nenit 248 te KPRK-ës, ashtu qe i propozoi gjykatës qe te aprovojë pranimin e

fajësisë të bere nga i akuzuari . Në fjalën e tij përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit A. Rr. av. Meshari Selimaj , deklaroi se me qene se i akuzuari e ka pranuar fajësinë konsiderojë se gjykata fillimisht duhet të këtë parasysh këtë rrethanë ligjore par pranimin i fajësisë e cila ngërthen ne vete edhe pendimin për veprën penale të kryer dhe premtimin se nuk do të kryej ne të ardhmen vepra tjera penale apo të këtëj lloji, andaj me këtë pikë me rastin e vendosjes lidhur me dënimin gjykata duhet të këtë parasysh këtë rrethanë lehtësuese. Po ashtu i kokrojmë gjykatës që të këtë parasysh edhe faktin e gatishmërisë se të akuzuarit dhe familjareve të tij për të kompensuar demin e shkaktuar për të dëmtuarin ,gjithashtu gjykata të këtë parasysh edhe karakteristikat personale të akuzuarit siç është moshë e tij e re , fakti se është i pa punë, fakti se është i pa martuar , edhe fakti i shkollimit të tij të mesëm , po ashtu fakti tjetër se me par nga gjykatat në Kosovë nuk është dënuar për ndonjë vepër penale , andaj këto janë arsyet e mjaftueshme përmes të cilave unë si mbrojtës dhe ne si pale ne procedurë të kërkojmë gjykatës që të njëjtit ti shqiptojë një dënim sa me të but për veprën penale me të cilën ngarkohet.

I dëmtuari G. K. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, sa i përket ndjekjes penale i le ne vlerësim të gjykatës por kërkojë kompensim demit që me është shkaktuar gjegjësisht kthimin e automjetit . Në fjalën përfundimtare i dëmtuari G. K. në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit duke shtuar se demit që me është shkaktuar nga këtu i akuzuari me marrjen e automjetit me ka shkaktuar humbje në biznesin të cilën e ushtrojë me që nga data kur me është marr e deri me sot nuk me është kthyer.pa përjashtuar edhe faktin se kam udhëtuar disa here ne Tiranë për të gjetur automjetin dhe kjo me ka kushtuar me kohë .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurorja e shtetit Mone Syla , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bere ne mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij , av. Meshari Selimaj , pasi që i ka kuptuar pasojat dhe favoret e sqaruar nga ana e gjykatës dhe ne rastin konkret mund të deklaroi se duke u bazuar në faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit ka mbështet ne provat materiale dhe personale të cilat e mbështesin aktakuzën , ku formohen të gjitha elementet e veprës penale të mashtrimit 323/1 të KPRK-ës me të cilën ngarkohet i akuzuari .Prokurorja e shtetit Mone Syla deklaroi me që i akuzuari ne këtë shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës, e cila edhe është e mbështetur ne provat dhe faktet e aktakuzës , pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave që i përmban aktakuza si ato personale dhe materiale deklaroi se aktakuza përmban mirë figurën e veprës penale të mashtrimit nga neni 323 par .1 të KPRK-ës, prandaj gjykatës i propozoi që të akuzuarit të shpallë fajtor ,të dënohet sipas ligjit duke i marr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese siç është pranimi i fajësisë e po ashtu edhe ato renduese të parapara me ligj dhe të obligohet ne kompensimin e demit të shkaktuar të dëmtuarit dhe shpenzimeve të procedurës penale .

2. Vlersimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjykuese në shqyrtim gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari A. R. , ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara , pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. Meshari Selimaj , pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuar nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës. Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari

e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 të KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Në shqyrtimin gjykata gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. R.: - **me dt.22.06.2022 rreth orës 12:00, në Rr..” . . ” në Gjakovë, konkretisht tek renta-car “. . .”** me anë të paraqitjes së rreme të fakteve dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, i pandehuri A.e mashtron të dëmtuarin G. K., në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike kishte shkuar tek i dëmtuari G. i cili kishte biznes për lëshimin e veturave me qira dhe aty kishte marrë me qira një veturë të tipit “. . .” me targa . . .për ta shfrytëzuar për dy ditë deri me dt.24.06.2022 por duke mos e bërë pagesën, ashtu qe me dt.24.06.2022 i dëmtuari e telefon për t’ia kthyer veturën por i pandehuri i thotë se do ta mbaj edhe një dite deri me dt.25.06.2022, pasi që e kishte vajzën e sëmure por që edhe pas kësaj date nuk ia kthen veturën, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton dëm material. **-me çka ka kryer veprën penale Mashtrim nga neni 323 ar.1 të KPRK-së.**

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 323 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të mashtrimit e kryen: *“Kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet ose në çfarëdo mënyre tjetër mashtruese dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër , ose për ti shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo mos kryej një veprim , i cili rezulton në dëm material të pasurisë së tij /saj apo pasurisë së personit tjetër ose rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme për veten apo personin tjetër , dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre(3) muaj deri në pesë(5) vjet.*

5. Vendimi i gjyqtarës së vetme gjykuese

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese të akuzuarin A. R. , e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale të Mashtrimit , nga neni 323 par.1 të KPRK-së dhe bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marr për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë rënduese gjykata mori peshën e veprës penale , mënyrën dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra penale e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi , ku

i tek i akuzuari ka ekzistuar dashje e lartë për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata mori parasysh personalitetin e të akuzuarit se i njëjti është i moshës relativisht të re ,gjendjen e tij të dobët ekonomike, sjelljet tejet korrekte në Gjykim, bashkëpunimi me organet e rendit, përkatësisht me gjykatë dhe me prokurori, pranimi i fajësisë, pendesa e thellë të cilën e ka shprehur, shprehja e keqardhjes për rastin që i ka ndodhur, kërkim falje publike të dëmtuarit, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet si dhe gatishmërinë e shprehur për kompensimin e dëmit të dëmtuarit . Duke u bazuar në këto rrethana gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 70 të KPRK-së ë kur ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit dhe ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata me aktvendim të posaçëm P.nr.330/22 të datës 30.08.2022, ka vazhduar paraburgimin ndaj tani të akuzuarit A. R. , konform nenit 367 par. 1 nën par.1.1 , par. 3, 6 ,7 të KPPK- së, dhe atë deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi.

7.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin , për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike .

8.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË **-Departamenti i përgjithshëm-** **P. nr.330/22 më datë 30.08.2022**

Sekretarja juridike
Flutur Nagavci

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Illirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.